



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 771/3 Prot.

Tiranë, më 14 .06 . 2021

**V E N D I M**

**Nr. 107, Datë 14 .06 . 2021**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 98, datë 27.05.2021, të paraqitur nga shtetasi M.K kundër Komisarariatit të Policisë Berat dhe Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Berat, në të cilën pretendohet diskriminim, pa përcaktuar shkakun.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, subjekti ankues në mes të tjerash, informon se: *“Komisaritati i Policisë Berat dhe shërbimi policor i I EVP Berat, pa asnjë shkak ligjor, kanë vijuar lëvizjet e tyre të datës 14.05.2021, nga Spitali Rajonal Berat dhe anasjelltas, me ankuesin e prangosur dhe me duar të kthyera prapa. Ankuesi kërkon konstatimin e diskriminimit, lidhur me mungesën e mjekimit për të përfunduar në kohë dhe rregullisht, mjekimin e dhëmbit shumë të dëmtuar që vazhdon ti shkaktojë dhimbje. Ankuesi kërkon konstatimin e diskriminimit në lidhje me vijimin e mungesës së mjekimit që sipas tyre, për shkak të mungesës së mjeteve financiare për blerjen e medikamenteve sipas komunikimeve të mjekëve specialistë. Gjithashtu, ankuesi kërkon konstatimin e diskriminimit në lidhje me vijimin e mungesës së plotë të komunikimit, përfshirë dhe mungesën për kryerjen e bisedave telefonike me numrat e gjelbër, papagesë”.*

**II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:**

Në nenin 1 të Ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet*

*politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Bazuar në nenin 3/1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : “*çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”. Ndërsa në pikën 2, të po këtij neni, parashikohet se: “*Diskriminim i drejtpërdrejtë*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave, Komisioneri ndjek procedurën ligjore, të parashikuar në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri evidenton së pari, nëse ankuesi është ekspozuar ndaj një qëndrimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e subjektit/eve kundër së cilit drejtohet ankesa.

Referuar parashikimit të nenit 1, marrë së bashku me përkufizimin e diskriminimit, që ligji ka bërë në nenin 3, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Neni 1, i ligjit, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është shteruese, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes “*për çdo shkak tjetër*”. Për të vlerësuar nëse pretendimet e ankuesit në lidhje me shkakun e mbrojtur gëzojnë mbrojtje nga parashikimi “*çdo shkak tjetër*”, Komisioneri do të mbajë në konsideratë praktikën e Gjykatës Europiane të të

Drejttave të Njeriut<sup>1</sup>, në drejtim të interpretimit të shkaqeve/statuseve të tjera sipas nenit 14 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut<sup>2</sup>.

Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme, objektive ose personale, ose “*status*”, me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri<sup>3</sup>. Gjykata ka theksuar se fjalës “*shkak/status tjetër*” në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë.<sup>4</sup> Gjykata fillimisht vëren që, ndërsa një numër i shembujve konkretë kanë të bëjnë me karakteristikat që mund të thuhet se janë “*personale*” në kuptimin që ato janë karakteristika të lindura ose të lidhura natyrshëm me identitetin ose personalitetin e individit, të tilla si seksi, raca dhe feja, jo të gjitha shkaqet e listuara mund të karakterizohen kështu.

Duke mbajtur në konsideratë standartin e mësipërm, Komisioneri vlerëson se ankuesi nuk ka identifikuar një shkak për trajtimin e padrejtë apo më pak të favorshëm, të pretenduar prej tij. Për diskriminimin e pretenduar ankuesi duhet të identifikonte një shkak, i cili ka shërbyer si bazë për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të pretenduar nga ana e tij.

Përveç sa më sipër, ankuesi nuk ka depozituar asnjë provë dhe fakt konkret, që të provojë situatën për të cilën pretendon diskriminim.

Në shkresën e dërguar, rezulton se ankuesi nuk ka dhënë një shpjegim të ngjarjes dhe fakteve të pretenduara si dhe nuk ka depozituar pranë KMD-së asnjë akt që të vërtetojë pretendimet e tij, lidhur me trajtimin e padrejtë e disfavorizues ndaj së cilit ai është ekspozuar. Ankuesi ka depozituar pranë Komisionerit, vetëm shkresat drejtuar Gjykatës së Apelit Vlorë, në të cilën ka kërkuar prishjen e Vendimit datë 04.05.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, shkresën drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Berat, në të cilën ka kërkuar kopje të plotë të të gjithë fashikullit të hetimit për të cilin është dhënë Vendimi datë 04.05.2021 dhe kërkesën drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Berat, në të cilën ka kërkuar kopje të plotë të gjithë korrespondencës së tij me DVP-në Berat nga viti 2014 e në vijim. Në këto kushte, KMD vë në dukje faktin se për shqyrtimin e kësaj ankese nuk ekzistojnë indicie të mjaftueshme për të filluar një procedim administrativ. Në parim, duhet të ekzistojnë fakte dhe prova konkrete që dëshmojnë për shkaqe të provuara diskriminimi, si dhe duhet të ketë informacion të mjaftueshëm për të iniciuar një hetim administrativ.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se informacioni i ankuesit nuk mund të konsiderohet pretendim për diskriminim, dhe për rrjedhojë ankesa e paraqitur është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën GJEDNJ.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KEDNJ.

<sup>3</sup> Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70.

<sup>4</sup> Shih: *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 70.

Bazuar në nenin 32/1/a, të këtij ligji, Komisioneri ka kompetencë të shqyrtojë vetëm ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

Bazuar në nenin 33/4, germa “ç”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ..... ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në neni 33/4, germa “ç”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon subjektit ankues, që për problematikën e tij, t’i drejtohet Avokatit të Popullit, i cili në kuadër të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës, është institucioni i cili ka në funksion të detyrës së tij dhe trajtimin e rasteve në fjalë.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç dhe 10 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr. 98, datë 27.05.2021, të paraqitur nga shtetasi M.K.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**